

Horizon Shpk

Pasqyrat Financiare

për ushtrimin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015

(dhe raporti i audituesit te pavarur)

PERMBAJTJA:

RAPORTI I AUDITUESIT TE PAVARUR	I,II
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	1
PASQYRA E PERFORMANCES	2
PASQYRA E FLUKSIT TE MJETEVE MONETARE	3
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NE KAPITALIN NETO	4
1. Informacion i pergjithshem	5
2. Permbledhje e politikave te rendesishme kontabile	5
3. Mjete monetare dhe ekuivalente me to	8
4. Kerkesa tregtare dhe te tjera te arketueshme	8
5. Tatim fitimi i parapaguar	8
6. Te tjera te arketueshme	8
7. Aktive afatgjate materiale	9
8. Furnitore dhe detyrime te tjera	9
9. Provizione per shpenzime	10
10. Grante	10
11. Kapitali i nenshkruar	11
12. Te ardhura te shfrytezimit	11
13. Shpenzime per materiale	11
14. Shpenzime personeli	11
15. Shpenzime te pergjithshme administrative	12
16. Shpenzimi i Tatimit mbi fitimin	12
17. Ngjarje te tjera pas dates bilancit	12

Horizon Shpk

Pasqyra e Pozicionit Financiar


(Gjithe vlerat ne Leke)

	Shenime	31 Dhjetor 2015	31 Dhjetor 2014
AKTIVET			
Aktive afatshkurtra			
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	3	29.327.673	32.210.327
Kerkesa tregtare dhe te tjera te arketueshme	4	42.032.736	38.841.835
Tatim fitimi i parapaguar	5	2.014.467	4.998.892
Inventari		40.667.382	47.248.513
Te tjera te arketueshme	6	2.792.904	1.445.506
Totali i aktiveve afatshkurtra		116.835.162	124.745.073
Aktive afatgjate			
Aktive afatgjata materiale	7	3.658.343	3.697.701
Totali i aktiveve afatgjata		3.658.343	3.697.701
TOTALI I AKTIVEVE		120.493.505	128.442.774
DETYRIMET DHE KAPITALI			
Detyrime afatshkurtra			
Furnitore dhe detyrime te tjera	8	15.591.200	45.474.315
Provizione per shpenzime	9	-	2.464
Totali i detyrimeve afatshkurtra		15.591.200	45.476.779
Detyrime afatgjate			
Grante	10	33.281.437	34.099.661
Total i detyrimeve afatgjata		33.281.437	34.099.661
Detyrime totale		48.872.637	79.576.440
Kapitali dhe rezervat			
Kapitali i nenshkruar	11	500.000	500.000
Rezerva ligjore		50.000	50.000
Fitimi i pashpermdare		48.316.365	26.018.842
Fitimi i vitit		22.754.503	22.297.492
Totali i kapitaleve te veta		71.620.868	48.866.334
TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT		120.493.505	128.442.774


Pasqyra e pozicionit financiar duhet lexuar se bashku me shenimet shpjeguese ne faqet 5 deri 14 qe jane pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare dhe shenimet shpjeguese nga faqja 1 deri 12 jane firmosur dhe miratuar me 31 Mars 2016 nga:

Administratori
Vasileios Stachos

Shefe Finance
Glediana Nakuci



Horizon Shpk

Pasqyra e Performances

(Pasqyra e te ardhurave dhe shpenzimeve)

(Gjithe vlerat ne Leke)

		Viti i mbyllur ne 31 Dhjetor	
		2015	2014
Te ardhurat te shfrytezimit	12	118.454.371	97.072.326
Te ardhura te tjera		-	775.885
Te ardhurat nga grantet	10	6.999.801	3.541.051
Shpenzime per materiale	13	(60.676.622)	(27.979.321)
Shpenzime per konsulenca		(7.319.951)	(5.187.803)
Shpenzime personeli	14	(16.785.333)	(27.378.490)
Shpenzime te pergjithshme dhe administrative	15	(11.308.256)	(13.466.435)
Provizion per shpenzime tatimore	11	-	(2.464)
Amortizimi i aktiveve afatgjata materiale	7	(922.961)	(1.106.539)
Rezultati nga veprimtarite shfrytezuese		28.441.049	26.268.210
Te ardhura/(shpenzime) financiare		(1.570.537)	90.354
Fitimi para tatimit		26.870.512	26.358.564
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	16	(4.116.009)	(4.061.072)
Fitimi i vitit		22.754.503	22.297.492
Te ardhura te tjera gjithëpërfshirëse per vitin		-	-
Totali i te ardhurave gjithëpërfshirëse per vitin		22.754.503	22.297.492

Pasqyra e performances duhet lexuar së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 deri 12 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Horizon Shpk

Pasqyra e Fluksit te Mjeteve Monetare

(Gjithe vlerat ne Leke)

Shenime	Viti i mbyllur 31 Dhjetor	
	2015	2014
Flukse monetare nga veprimtaria		
Fitimi para tatimit	26.870.512	26.358.564
<i>Rregullime per:</i>		
Amortizimin	7 922.961	1.106.539
Provizion	(2.464)	2.464
Fitimi nga veprimtarite para ndryshimeve ne kapitalin punues	<u>27.791.009</u>	<u>27.467.567</u>
(Rritja)/zvogelim e kerkesave per arketim	(4.538.268)	47.682.654
(Rritja)/zvogelim ne inventar	6.581.131	3.324.659
Rritja/(zvogelim) e llogarive te pagueshme	(29.883.114)	(53.804.912)
Tatim fitimi i paguar	5 (1.131.584)	(8.987.299)
Mjete monetare neto nga veprimtarite e shfrytezimit	<u>(1.180.826)</u>	<u>15.682.669</u>
Flukse monetare nga veprimtarite investuese		
Kredi nga aksioneri		(32.000.000)
Blerje e aktiveve afatgjata materiale	(883.603)	(357.339)
Mjete monetare perdorur ne veprimtarite investuese	<u>(883.603)</u>	<u>(32.357.339)</u>
Flukse monetare nga veprimtarite financuese		
Dividende te paguar	-	(28.000.000)
Grante te marra	(818.225)	34.099.661
Kredi afatshkurter	-	(14.155)
Mjete monetare perdorur ne veprimtarite financuese	<u>(818.225)</u>	<u>6.085.506</u>
Rritja neto e mjeteve monetare	(2.882.654)	(10.589.164)
Mjete monetare ne fillim te vitit	3 32.210.327	42.799.491
Mjete monetare ne fund te vitit	<u>3 29.327.673</u>	<u>32.210.327</u>

Pasqyra e flukseve monetare duhet lexuar së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 deri 12 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Horizon Shpk

Pasqyra e Ndryshimeve ne Kapitalin Neto

(Gjithe vlerat ne Leke)

	Kapitali themeltar	Rezerva ligjore	Fitimi i pashperndare	Fitimi i vitit	Totali
Pozicioni financiar me 01 Janar 2014	500.000	50.000	54.018.873		54.568.873
Te ardhurat totale gjithëpërfshirëse te vitit:					
Kapitali themeltar					
Fitimi i vitit				22.297.492	22.297.492
Te ardhurat totale gjithëpërfshirëse te vitit				-	-
Totali i te ardhurave gjithëpërfshirëse per vitit	-	-	-	22.297.492	22.297.492
Transaksione per pronaret e njësisë ekonomike te njohura direkt ne kapital:					
Dividende te shperndare			(28.000.000)		(28.000.000)
Totali i transaksioneve per pronaret e njësisë ekonomike	-	-	(28.000.000)		(28.000.000)
Pozicioni financiar me 31 Dhjetor 2014	500.000	50.000	26.018.873	22.297.492	48.866.365
Te ardhurat totale gjithëpërfshirëse te vitit:					
Kapitali themeltar					
Fitimi i vitit				22.754.503	22.754.503
Totali i teardhurave gjithëpërfshirëse per vitit	-	-	-	22.754.503	22.754.503
Transaksione per pronaret e njësisë ekonomike te njohura direkt ne kapital:					
Riklasifikim i Fitimit te vitit 2014 ne fitimet e pashperndara			22.297.492	(22.297.492)	
Totali i transaksioneve per pronaret e njësisë ekonomike	-	-	22.297.492	(22.297.492)	-
Pozicioni financiar me 31 Dhjetor 2015	500.000	50.000	48.316.365	22.754.503	71.620.868

Pasqyra e ndryshimeve ne kapitalin neto duhet lexuar së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 deri 12 që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

1. INFORMACION I PERGJITHSHEM

Shoqëria "Horizon" Shpk. (me poshte "Shoqëria") është krijuar si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në datë 23/09/2005.

Objekti kryesor i veprimtarisë së shoqërisë përfshin veprimtari në fushën e teknologjisë, duke ofruar krijimin dhe integrimin e sistemeve të informacionit për shoqëri dhe individë, import, eksport si dhe shitje të pajisjeve informatike, produkteve hardware dhe software dhe programe në tregun vendas dhe atë të huaj.

Me 31 Dhjetor 2015 shoqëria kishte 13 të punësuar (31 Dhjetor 2014 : 11 punonjës). Adresa e shoqërisë është rruga Njesia Bashkiake Nr. 5, Rruga Ismail Qemali, Pallati Nr. 27, Kati 4, Hyrja Nr. 19, Tiranë. Shoqëria është regjistruar si tatimpagues në rrethin e Tiranës me NIPT K52225004V.

Pasqyrat financiare të shoqërisë për ushtrimin e mbyllur me 31 Dhjetor 2015 janë miratuar nga Administratori i shoqërisë me 31 Mars 2015.

2. PERMBLEDHJE E POLITIKAVE TE RENDESISHME KONTABILE

a. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

Pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjithë aspektet materiale, në përputhje me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK), të cilat përbehen nga rregullat dhe interpretimet në përputhje me Ligjin nr.9228 datë 29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare".

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike. Të dhënat aktuale dhe krahasuese janë prezantuar në Lek Shqiptare (LEK), që është monedha raportuese e shoqërisë.

b. Aktivitet afatgjatë materiale dhe jomateriale

(i) Njohja dhe matja

Të gjitha aktivitet afat-gjatë materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitet. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitet në gjëndje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe koston e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes si në gjëndjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivitet. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivitet kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivitet afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentet më të mëdhenj) të aktiveve afat-gjatë materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur, dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave.

(ii) Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjatë materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afat-gjatë materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

**2. PERMBLEDHJE E POLITIKAVE TE RENDESISHME KONTABILE
(VAZHDIM)****b. Aktivet afatgjata materiale dhe jomateriale (vazhdim)**

pason muajin e blerjes. Aktivet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivit. Toka nuk amortizohet.

Norma e amortizimit per periudhën aktuale jane si më poshtë:

Kategoria	Metoda e amortizimit	Norma e amortizimit
Instalime teknike	Mbi vlerën kontabël neto	5%
Mobilje dhe pajisje zyre	Mbi vlerën kontabël neto	20%
Pajisje informatike	Mbi vlerën kontabël neto	25%
Të tjera	Mbi vlerën kontabël neto	20%

Aktivitet afatgjata jomateriale njihen atehere kur eshte e mundur qe te perfitime ekonomike do te sigurohen ne te ardhmen ne lidhje me keto aktive dhe kostoja e tyre mund te matet ne menyre te besueshme.

c. Inventari

Inventaret jane paraqitur ne pasqyrat financiare te Shoqerise duke perdorur vleren e blerjes se tyre qe eshte me e vogel se vlera neto e realizueshme. Per inventarizim shoqeria ka perdorur metoden periodike dhe per vleresimin ka perdorur metoden e koston mesatare.

d. Llogarite e arketueshme dhe llogari te pagueshme

Llogaritë e arketueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit per zhvlerësimin e aktiveve të arketueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Veshtrësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentoje ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arketueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

e. Paraja dhe ekuivalentet e parase

Paraja dhe ekuivalentet e parase përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat në Lek dhe në monedha të huaja. Për qëllimin e pasqyrës së flukseve monetare, paraja dhe ekuivalentet e saj përfshijnë depozita pa afat ose me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

f. Transaksionet në monedhe të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Asetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare si dhe parapagimet në lidhje me AAM

2. PERMBLEDHJE E POLITIKAVE TE RENDESISHME KONTABILE (VAZHDIM)**f. Transaksionet ne monedhe te huaj (vazhdim)**

për t'u blerë në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kurset zyrtare të këmbimit për monedhat kryesore të përdorura në konvertimin e zërave të bilancit në monedhë të huaj ishin si më poshtë (në Lek):

	<u>31 Dhjetor 2015</u>	<u>31 Dhjetor 2014</u>
1 EUR	137,28	140,14
1 USD	125,79	115,23

g. Njohja e te ardhurave

Të ardhurat njihen në masën që është e mundshme që përfitimet e ardhshme ekonomike do ti vijin kompanisë dhe këto përfitime mund të maten në mënyrë të besueshme. Shpenzimet njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve kur ato kryhen. Të ardhurat dhe shpenzimet regjistrohen në pasqyrat financiare të periudhës të cilës i përkasin.

h. Tatimi mbi fitimin

Tatimi mbi fitimin është llogaritur në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi për tatimin mbi fitimin për periudhën e mbyllur më 31 Dhjetor 2015. Tatimi mbi fitimin përfshin tërësisht tatimin mbi fitimin e llogaritur për periudhën kontabël. Tatimi aktual mbi fitimin llogaritet si 15% e fitimit të tatueshëm të përcaktuar në legjislacionin e kontabilitetit dhe legjislacionin tatimor në Shqipëri për vitin 2015 (2014: 15%).

i. Fondet per pensione

Shoqëria paguan kontributet për pensione si edhe kontribute për sigurim shëndetsore për punonjësit e saj sic është parashikuar nga legjislacioni social vendas. Kontributet, bazuar në pagat, janë paguar në llogaritë organizmave kombëtare përgjegjës për pagesën e pensioneve dhe shpenzimeve shëndetsore. Nuk ka asnjë detyrim tjetër në lidhje me fondin për pensione dhe shpenzime shëndetsore.

j. Krahasueshmëria

Informacioni krahasues paraqitet në mënyrë të vazhdueshme, duke aplikuar politikat kontabël të Shoqërisë dhe duke u bazuar në modelin e pasqyrave financiare sipas sistemit kontabël Shqiptar.

k. Biznesi ne vijimesi

Te dhenat e kontabilitetit janë mbajtur duke qene në përputhje me parimet e përgjithshme të kontabilitetit, në mënyrë të vecante me bazën e matjes me kosto historike, parimin e kontabilitetit rrjedhës, konceptin e kujdesit dhe me supozimin e biznesit në vijimesi. Pasqyrat financiare janë përgatitur sipas parimit të vijimesisë, i cili parashikon realizimin e aktiveve dhe shlyerjen e detyrimeve gjatë ecurisë normale të biznesit.

7. AKTIVE AFATGJATE MATERIALE

	Pajisje informatike	Pajisje zyre	Te tjera	Mjete Transporti	Totali
Kosto					
Me 01 Janar 2014	9.817.052	3.691.527	464.877		13.973.456
Shtesa	301.440	55.898	-		357.338
Me 31 Dhjetor 2014	10.118.492	3.747.425	464.877		14.330.794
Shtesa	158.423	-	29.280	695.900	883.603
Me 31 Dhjetor 2015	10.276.915	3.747.425	494.157	695.900	15.214.397
Amortizimi i akumuluar					
Me 01 Janar 2014	(6.512.751)	(2.771.528)	(242.497)		(9.526.776)
Amortizimi per vitin	(868.529)	(193.316)	(44.472)		(1.106.317)
Me 31 Dhjetor 2014	(7.381.280)	(2.964.844)	(286.969)		(10.633.093)
Amortizimi per vitin	(702.789)	(156.516)	(40.462)	(23.194)	(922.961)
Me 31 Dhjetor 2015	(8.084.069)	(3.121.360)	(327.431)	(23.194)	(11.556.054)
Vlera kontabel neto:					
Me 01 Janar 2014	3.304.301	919.999	222.379		4.446.679
Me 31 Dhjetor 2014	2.737.212	782.581	177.908	-	3.697.701
Me 31 Dhjetor 2015	2.192.846	626.065	166.726	672.706	3.658.343

8. FURNITORE DHE DETYRIME TE TJERA

	31 Dhjetor 2015	31 Dhjetor 2014
Furnitore	9.571.153	11.069.865
TVSH e pagueshme neto	2.276.407	2.198.656
Paga te pagueshme	28.727	1.811.202
Taksa dhe tatime te tjera	429.206	1.239.114
Dividende te pagueshem	-	25.200.000
Te ardhura te periudhave te ardhme	2.135.787	2.672.055
Shpenzime te perlogaritura	1.120.125	1.191.165
Detyrime te tjera	29.795	92.258
Totali	15.591.200	45.474.315

8. FURNITORE DHE DETYRIME TE TJERA (VAZHDIM)

PARAPAGIM/ (DETYRIM) PER TVSH

	31 Dhjetor 2015	31 Dhjetor 2014
TVSH e pagueshme mbartur nga viti paraardhes	(2.198.656)	1.446.459
TVSH e llogaritur (rubrika 12)	(24.173.644)	(19.003.857)
TVSH i zbritshem blerje (rubrika 17)	12.346.659	6.409.683
TVSH e paguar gjate vitit ushtrimor	11.749.234	8.949.059
Parapagim / (Detyrim) per TVSH	(2.276.407)	(2.198.656)

9. PROVIZIONE PER SHPENZIME

	31 Dhjetor 2015	31 Dhjetor 2014
Ne 1 Janar	2.464	-
Perdorur gjate vitit perpenalitetet e gjoba	(2.464)	-
Kaluar si e ardhur gjate vitit	-	-
Porvizioneper rrezique e shpenzime	-	-
-Shtesa perceshtje tatimore	-	2.465
Ne 31 Dhjetor	-	2.465

Provizionet perceshtje tatimore perfaqesojne parashikimet e drejtimit perpagesen e gjobave dhe kamatvonesave sipas njoftim vleresimit tatimor ne Janar 2014.

10. GRANTE

Subvencionet lidhen me pjese garancie falas nga furnitore te huaj dhe gjate 2015 paraqiten si me poshte:

	31 Dhjetor 2015	31 Dhjetor 2015
Subvencione ne fillim	34.099.661	-
Shtesa gjate vitit	(6.999.801)	37.640.712
Ri-marrje gjate vitit	6.181.577	(3.541.051)
Subvencione ne fund	33.281.437	34.099.661

Horizon Shpk

Shenimet e pasqyrave financiare

Per ushtrimin e mbyllur me 31 Dhjetor 2015

11. KAPITALI I NENSHKRUAR

Kapitali i nenshkruar dhe struktura aksionare me 31 Dhjetor 2015 dhe 2014 paraqiten si me poshte:

	31 Dhjetor 2015		31 Dhjetor 2014	
	Ne %	Ne Vlere	Ne %	Ne Vlere
TheodorosStachos	100%	500.000	100%	500.000
	100%	500.000	100%	500.000

Ne 31 Dhjetor 2015 kapitali akionar perbehej nga 5.000 kuota me vlere nominale 100 Lek/ secili (2014: 5.000 kuota me vlere nominale 100 Lek/ secili).

12. TE ARDHURA TE SHFRYTEZIMIT

	Viti i mbyllur	Viti i mbyllur
	31 Dhjetor 2015	31 Dhjetor 2014
Te ardhura nga shitje sherbime	67.792.926	73.021.073
Te ardhura nga shitje mallra	50.428.139	24.051.253
Te ardhura te tjera	233.306	
Totali	118.454.371	97.072.326

Ne shifren e afarizimit dhe TVSh-n e llogaritur ne blerje dhe shitje sipas sistemit tatimor eshte perfshire edhe vlere e tatueshme Lek 4.275.141 (Lek 2.287.764 ne 2014) per autofaturimet sipas nenit 15, pika 5 te ligjit 7928 per "Tatimin mbi Vleren e Shtuar" e cila nuk perfaqeson nje te ardhur per shoqerine.

13. SHPENZIME PER MATERIALE

	Viti i mbyllur	Viti i mbyllur
	31 Dhjetor 2015	31 Dhjetor 2014
Kosto e mallrave	53.676.821	24.438.270
Kosto e mallrave nga subvencionet	6.999.801	3.541.051
Totali	60.676.622	27.979.321

14. SHPENZIME PERSONELI

	Viti i mbyllur	Viti i mbyllur
	31 Dhjetor 2015	31 Dhjetor 2014
Pagat	14.862.639	25.019.654
Sigurimet shoqerore	1.922.694	2.358.836
Totali	16.785.333	27.378.490

Horizon Shpk**Shenimet e pasqyrave financiare****Per ushtrimin e mbyllur me 31 Dhjetor 2015****15. SHPENZIME TE PERGJITHSHME ADMINISTRATIVE**

	Viti i mbyllur 31 Dhjetor 2015	Viti i mbyllur 31 Dhjetor 2014
Qira	4.414.133	4.804.524
Sherbime profesionale	388.436	794.944
Udhetime dhe dieta	716.851	692.044
Karburant	951.200	1.486.000
Uje, drita	525.883	479.037
Postare dhe komunikimi	1.280.787	1.849.514
Gjoha dhe demshperblime	6.223	11.012
Komisione bankare	476.304	589.763
Shpenzime te tjera operative	2.548.439	2.759.597
Totali	11.308.256	13.466.435

16. SHPENZIMI I TATIMIT MBI FITIMIN

	31 Dhjetor 2015	31 Dhjetor 2014
Fitimi para tatimit	26.670.512	26.358.564
Te ardhura te patatueshme		(598.080)
<i>Efekti tatimor i shpenzimeve qe nuk jane te zbritshme per qellime tatimore</i>		
Shpenzime per pritje dhe perfaqesime mbi kufirin tatimor	-	59.602
Gjoha dhe demshperblime	6.223	11.012
Provizione	-	2.464
Shpenzime pa dokumentacion te rregullt	340.234	
Te tjera fatura	-	
Shpenzime marketingu	-	532.600
Shpenzime te tjera	223.094	707.649
Fitimi I tatueshem	27.440.063	27.073.811
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	4.116.009	4.061.072

17. NGJARJE TE TJERA PAS DATES BILANCIT

Nuk ka asnje ngjarje te rendesishme pas mbylljes se vitit ushtrimor qe te kerkoje korrigjime apo pershkrime ne keto pasqyra financiare.